REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYİE
02 Nr/Br/No. 366
Data/Datum/Tarih 30.03.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

## ZYRA E KRYETARIT
## KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenin 78 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës, e në zbatim të nenit 26 dhe 27 të LSHCK nr.03/L-149, nenin 41 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civil lidhur me nenin 5 të Rregullores nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civilë, e në zbatim të Vendimit të KPMSHCK A.nr 5012018 të dates 30.03.2018 për vazhdimin e procedurës së rekrutimit sipas konkursit të shpallur nr.02/016-62710 të datës 23.06.2017 dhe vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.95712018 të dates 31.05.2021 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr.695 të dates07.03.2022, pas shqyrtimit të Raportit final të rekomandimit nga Komisioni përzgjedhës i shërbyesve civilë të datës 27.03.2023 për plotësimin e pozitës punuese; Udhëheqës i Sektorit Administrativ në kuadër të DUPMM, nxjerrë:

## VENDIM
## PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINAL TË REKOMANDIMIT TË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS TË SHËRBYESVE CIVIL

1.**Aprovohet** raporti final i rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës të Shërbyesve Civil sipas shpalljes së brendshme për avancim në karrierë të datës, **23.06.2017** e i vazhduar deri më datë **17.07.2017** publikuar në web faqen dhe tabelen e shpalljeve komunale për plotësimin e pozitës punuese: **Udhëheqës i Sektorit Administrativ**, andaj Përzgjedhet dhe emërohet kandidati më i suksesshëm sipas pikëve të fituara në testimin me shkrim dhe me gojë si në vijim:

**1.1 Udhëheqës i Sektorit Administrativ, nr.i ref. JP00029378**

**Bashkim Isufi.......................................................................................................... 71 pikë**

2.Akti zyrtar i emërimit të kandidatit të përzgjedhur dhe emëruar do të lëshohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit, protokollimit dhe publikimit të këtij vendimi, ku i njëjti do të njoftohet me shkrim me çka edhe përfundon procedura e rekrutimit.

3.Autorizohet njësia e përsonelit që të publikojë vendimin mbi rezultatet e procedurës së rekrutimit në tabelen komunale të shpalljeve dhe në web faqen e komunës.

4.Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokolimit.

**Këshilla juridike:** Kandidatët e pakënaqur me mos përzgjedhje dhe emërim në pozitën përkatëse mund të parashtrojnë ankesë KPMSHCK në afatin prej **30** ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**